
	<p>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit</p>	<p>DT-MO-010</p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>fage 1 nga 9</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		

**Operatori i Sistemit
të Transmisionit dhe Tregut
të Kosovës
(KOSTT)**


**Metodologjia për
Llogaritjen e Çmimit të Jobalancit dhe
Çmimit të Kompensimit**

Tetor 2016

	<p>Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit</p>	<p>DT-MO-010</p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>fage 2 nga 9</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		

PËRMBAJTJA

1.	OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI.....	3
2.	KOHA E APLIKIMIT TË METODOLOGJISË.....	3
3.	PËRGJEGJËSITË E PALËVE	3
4.	DEFINICIONET.....	5
5.	NDRYSHORET	6
6.	METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË ÇMIMIT TË JOBALANCIT	7
7.	ÇMIMI I ENERGJISË SË PROGRAMIT TË KOMPENSIMIT	8
8.	TË DHËNAT E APROVUARA NGA ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGJISË	9

	<p align="center">Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit</p>	<p align="center">DT-MO-010</p>
	<p align="center"><i>ver. 1.0</i></p>	<p align="center"><i>fage 3 nga 9</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		

1. Objektivat dhe fushëveprimi


- 1.1. Duke pasur parasysh mungesën e resurseve për balancim të sistemit në Kosovë si dhe përmirësimin e performancës së sistemit të Kosovës sa i përket balancimit të sistemit është e nevojshme që të përpilohet një metodologji për llogaritjen e çmimit të jobalanceve për palët tregtare në Kosovë.
- 1.2. Metodologjia referohet në nenin 1.8 të Rregullave të Tregut në lidhje me pamjaftueshmërinë e zhvillimit të konkurrencës me çmime të arsyeshme të tregut dhe mundësinë e aplikimit të çmimeve të rregulluara për jobalance.

2. Koha e aplikimit të metodologjisë


- 2.1. Kjo metodologji përcakton mënyrën e llogaritjes së çmimit të jobalancit të energjisë të palëve në tregun e energjisë elektrike në Kosovë në kushtet e mungesës së një tregut konkurrues.
- 2.2. Në kushtet e tregut konkurrues kjo procedurë nuk aplikohet.
- 2.3. Për ndërprerjen e aplikimit të kësaj metodologjie palët do të njoftohen nga ZRRE dy muaj më herët.

3. Përgjegjësitë e Palëve

- 3.1. Operatori i Tregut është përgjegjës të:
 - 3.1.1. Zbatojë këtë metodologji, përmirësojë dhe azhurnojë varësisht nga ndryshimet në legjislacionin primar dhe sekondar në Kosovë.
 - 3.1.2. Publikojë dhe vejë në dispozicion këtë metodologji për të gjitha Palët.
 - 3.1.3. Llogaritë jobalancet e palëve për çdo periudë të barazimit përfundimtar dhe obligimet që palët kanë për jobalancet e shkaktuara.
 - 3.1.4. Lëshojë faturat palëve në baza mujore për obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara në harmoni me nenin 18 të RrT.
- 3.2. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës të:

	<p align="center">Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit</p>	<p align="center">DT-MO-010</p>
	<p align="center"><i>ver. 1.0</i></p>	<p align="center"><i>fage 4 nga 9</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		

- 3.2.1. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat matëse meritore për llogaritje të çmimit të jobalancit.
- 3.2.2. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat e programit të shkëmbimit intraditor.
- 3.2.3. Jep instruksione ofruesve të shërbimeve balancuese për të blerë apo shitur energji për qëllim të balancimit të sistemit..
- 3.2.4. I vë në dispozicion Operatorit të Tregut të gjitha informatat sipas paragrafit 6.1.1 dhe 6.1.2
- 3.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës të:
- 3.3.1. Vejë në dispozicion të gjitha të dhënat matëse të konsumatorëve të kyçur në rrjetin e shpërndarjes të nevojshme për llogaritje të jobalancit të energjisë dhe çmimit të jobalancit.
- 3.4. Prodhuesit janë përgjegjës të:
- 3.4.1. Nominojnë një ditë para kapacitet e lira që mund të shfrytëzohen për balancim të sistemi.
- 3.4.2. Zbatojnë instruksionet e Operatorit të Sistemi për aktivizimin e ofertave për blerje dhe ofertave për shitje me çmim të ofertës për blerje dhe ofertës për shitje.
- 3.4.3. Vejnë në dispozicion për TSO apo DSO të gjitha të dhënat matëse relevante për llogaritjen e jobalancit dhe çmimit të jobalancit.
- 3.4.4. Paguajnë në baza mujore obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuara në harmoni me nenin 18 të RrT.
- 3.5. Furnizuesit janë përgjegjës të:
- 3.5.1. Paguajnë në baza mujore obligimet e tyre për jobalancet e shkaktuar në harmoni me nenin 18 të RrT.
- 3.6. Furnizuesi Publik është përgjegjës të:
- 3.6.1. Paguajë në baza mujore obligimet e tyre për jobalancet e shkaktura në harmoni me nenin 18 të RrT.
- 3.6.2. Të blejë/shes energji KOSTT për përmbushjen e obligimeve nga Programi i Kompensimi me çmimin e kalkuluar në nenin 6.4.2 të kësaj metodologjie në rolin e Palës së Posaçme.


	Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit	DT-MO-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 5 nga 9</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

3.6.3. Të zbatohet instruksionet e Operatorit të Sistemit për Shkryje të Konsumit si masë e fundit për balancimin e sistemit.

4. Definicionet

4.1. Termet e definuar në këtë metodologjie do të kenë kuptimet si në tabelën vijuese:


Termi i definuar	Interpretimi
Mekanizmi Balancues	është proces në të cilin Palët Tregtare i dorëzojnë Ofertat për Blerje dhe Ofertat për Shitje të energjisë OST, me qëllim të realizimit të Balancimit të Sistemit të Transmisionit në kohë reale;
Oferta për Blerje	është ofertë për të blerë energji elektrike nga OST në Mekanizmin Balancues me çmim të dhënë (në €/ MWh) nga Pala Tregtare për një Njësi Balancuese të caktuar;
Oferta për Shitje	është ofertë për t'i shitur energji elektrike OST në Mekanizmin Balancues me çmim të dhënë (në €/MWh) nga Pala Tregtare për një Njësi Balancuese të caktuar;
Çmimi i jobalancit	Çmimi i llogaritur sipas pikës 6.4 të kësaj metodologjie
Çmimi një ditë para	Çmimi i energjisë elektrike i publikuar nga tregu një ditë para HUPEX në Budapest për çdo periudhë të barazimit përfundimtar t për ditë të caktuar.
Koeficienti për shtyrje të energjisë	Koeficienti që shumëzohet me çmimin e simuluar të tregut kur jobalanci i sistemit është negativ (“sistemi shtynë në regjion”)
Koeficienti për tërheqje të energjisë	Koeficienti që shumëzohet me çmimin e simuluar të tregut kur jobalanci i sistemit është pozitiv (“sistemi tërheq nga regjioni”)
Pala e Posaçme	Është palë tregtare për të cilën aplikohen disa rregulla specifike, statusi i së cilës si Palë e Posaçme i njoftohet OT nga ana e ZRRrE.

	Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit	DT-MO-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 6 nga 9</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

Shkycja e konsumit	Është urdhëresa e dhënë nga TSO kur kjo e fundit e shoh të arsyeshme si masë të fundit për Furnizuesin Publik për të shkyçur ngarkesën në rastet kur jobalanci i sistemit është shumë i lartë.
Ofrues i energjisë balancuese	Palë tregtare që dorëzon oferta për shitje dhe oferta për blerje në mekanizmin balancues

5. Ndryshoret

Ndryshorja	Përshkrimi
ζ_{HUPEXj}	Çmimi nga tregu një dita para i organizuar nga bursa e energjisë HUPEX në Budapest për periudhën e barazimit përfundimtar j
ζ_{JBj}	Çmimi i jobalancit për periudhën e barazimit përfundimtar j
ζ_{kompj}	Çmimi i energjisë së programit të kompensimit për periudhën e barazimit përfundimtar
ζ_{OBJj}	Çmimi i ofertës për blerje për periudhën e barazimit përfundimtar j
ζ_{OSHj}	Çmimi i ofertës për shitje për periudhën e barazimit përfundimtar j
$EOSHj$	Energjia e liferuar si pasojë e aktivizimit të ofertës për shitje për periudhën e barazimit përfundimtar j
$EOBj$	Energjia e liferuar si pasojë e aktivizimit të ofertës për blerje j
$K_{shtyrje}$	Koeficienti i aplikueshëm kur jobalanci i sistemit është negativ
$K_{terheqje}$	Koeficienti i aplikueshëm kur jobalanci i sistemit është pozitiv

	Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit	DT-MO-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 7 nga 9</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

6. Metodologjia e llogaritjes së çmimit të jobalancit

6.1. Parametrat hyrës të metodologjisë

- 6.1.1. Energjia e liferuar me aktivizimin e ofertës për blerje në Mekanizmin Balancues
- 6.1.2. Energjia e liferuar me aktivizimin e ofertës për shitje në Mekanizmin Balancues
- 6.1.3. Çmimi i ofertës së aktivizuar për blerje.
- 6.1.4. Çmimi i ofertës së aktivizuar për shitje.
- 6.1.5. Koeficientet që shumëzohet me çmimin e Bursës së HUPEX për llogaritjen e çmimit të jobalancit
 - Koeficienti për shtyrje të energjisë në sistem
 - Koeficienti për tërheqje të energjisë nga sistemi
- 6.1.6. Jobalanci i sistemit.
- 6.1.7. Çmimet nga tregu një ditë para (Bursës) së HUPEX.

6.2. Të dhënat dalëse të metodologjisë.

- 6.2.1. Çmimi i jobalanceve për çdo periudë të barazimit përfundimtar.
- 6.2.2. Çmimi i programit të kompensimit për çdo periudë të barazimit përfundimtar.


6.3. Kur jobalanci i sistemit është pozitiv (sistemi tërheq) çmimi i jobalancit llogaritet ashtu që:

- 6.3.1. Kur nuk ka instruksion nga KOSTT për reduktim të ngarkesës për Furnizuesin Publik dhe ngritje të ngarkesës për Prodhuesin:

$$\zeta JB_j = \zeta_{HUPEX_j} \times K_{\text{terheqje}}$$

- 6.3.2. Kur ka instruksion nga KOSTT për aktivizimin e ofertave për shitje atëherë çmimi i jobalancit do të llogaritet sipas formulës:

$$\zeta JB_j = \frac{\sum (EOSH_j \times \zeta_{OSH_j})}{\sum EOSH_j}$$

	Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit	DT-MO-010
	<i>ver. 1.0</i>	<i>fage 8 nga 9</i>
<i>Departamenti: Operimi i Tregut</i>		

6.3.3. Instruksionet nga KOSTT për shkyçjen e konsumit do të konsiderohen si ofertë për shitje dhe çmimi i energjisë për shkyçje do të konsiderohet si çmim i ofertës për shitje:

6.4. Kur jobalanci i sistemit është negativ (sistemi shtynë) atëherë çmimi i jobalancit përcaktohet ashtu që:

6.4.1. Kur nuk ka instruksion nga KOSTT,

$$\zeta JB_j = \zeta_{HUPEX_j} \times K_{shtyrje}$$

6.4.2. Kur ka instruksion nga KOSTT për aktivizimin e ofertës për blerje, çmimi i jobalancit do të llogaritet me formulën.

$$\zeta JB_j = \frac{\sum (EOB_j \times \zeta_{OBJ_j})}{\sum EOB_j}$$


6.5. Kur sistemit është i balancuar atëherë çmimi i jobalancit përcaktohet si mesatare e thjeshtë e çmimit të jobalancit të 720 orëve paraprake.

7. Çmimi i energjisë së programit të kompensimit

7.1. Çmimi i programit të kompensimit është çmimi me të cilin KOSTT i shet energji FP ose blenë energji nga FP për nevoja të përmbushjes së obligimeve nga Programi i kompensimit.

7.2. Çmimi i programit të kompensimit për periodë të barazimit përfundimtar është i barabartë me çmimin e simuluar të sistemit për periodë të barazimit përfundimtar:

$$\zeta_{kompj} = \zeta_{HUPEX_j}$$

	<p align="center">Metodologjia për llogaritjen e çmimit të jobalancit dhe çmimit të kompensimit</p>	<p align="center">DT-MO-010</p>
	<p align="center"><i>ver. 1.0</i></p>	<p align="center"><i>fage 9 nga 9</i></p>
<p><i>Departamenti: Operimi i Tregut</i></p>		

8. Të dhënat e e aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë

8.1. Të dhënat e aprovuara nga ZRrE do të jenë:

8.1.1. Çmimi i ofertës për blerje.

8.1.2. Çmimi i ofertës për shitje.

8.1.3. Çmimi i energjisë për shkyçje të konsumit.

8.1.4. Koeficienti për shtyrje.

8.1.5. Koeficienti për tërheqje.

8.2. Vlerat e aprovuara sipas pikës 8.1 të këtij dokumenti janë dhënë në Shtojcën 1 e cila do të konsiderohet si pjesë integrale e kësaj metodologjie.

(Fundi i dokumentit)